



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal

Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 2 gusht 2022, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Doarsa Kica –Xhelili, Mërgim Lushtaku, Fidan Jilta, Valon Ramadani, Nijazi Isaku, Fitim Haziri, Besim Muzaqi, Isak Shabani, Agim Veliu dhe Besnik Tahiri.

Mungoi: Igor Simiq.

Në mbledhje mori pjesë: Bardhyl Dobra, zv. ministër i Ministrisë së MPB, Jeta Tela, Ibadete Mehmeti - MPB, GLPS dhe Ekonomia Online.

Stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Doarsa Kica –Xhelili, kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.7.2022;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-123 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të ekzekutive;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.7.2022;**

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-123 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive Ekzekutive;

Doarsa Kica-Xhelili, njoftoi anëtarët e komisionit, se Kryesia e Kuvendit e ka ngarkuar Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal për shqyrtimin në parim të Projektligjit nr. 08/L-123 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive ekzekutive.

Fjalën ia kaloi Zv.Ministrit të MPB-së, z.Bardhyl Dobra, për ta prezantuar projektligjin në fjalë.

Bardhyl Dobra, zv.ministër, tha se Qeveria ka miratuar p/ligjin në dhjetor të vitit 2021, me p/ligj racionalizohen dy agjenci, Agjencia për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore fuzionohet në departamentin gjegjës, në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa, Agjencia për efikasitet të energjisë shuhet dhe kompetencat e përgjegjësitë barten në strukturë organizative brenda ministrisë gjegjëse. Edhe për këto agjenci vlen termi Omnibus, ashtu sikur në valën e parë të racionalizimit.

Lidhur me këtë, kërkoi nga anëtarët e komisionit që çështjen e reformimit të administratës publike ta konsiderojnë si prioritet shtetëror dhe të votojnë p/ligjin në fjalë.

Isak Shabani, pyeti, a ka paraparë ministria rritjen e kapaciteteve, duke pasur parasysh faktin se Agjencia për Siguri Bërthamore nuk ka pasur kapacitete të mjaftueshme.

Bardhyl Dobra, tha se me fuzionimin e agjencisë në kuadër të Ministrisë, ministria do të rishikojë rregulloren dhe do të vlerësojë nevojën për kapacitetet e kuadrove.

Besnik Tahiri, reforma e agjencive ekzekutive dhe të pavarura e kanë pasur konceptin e racionalizimit dhe ndërtimit të vijave llogaridhënëse si prioritet që ka Kosova, por disa agjenci nuk kanë qenë në proces të racionalizimit, sidomos Agjencia për Efikasitetin e Energjisë dhe mbi këtë bazë propozoi të diskutohet, sa është i rëndësishëm racionalizimi i agjencisë, kur dihet se Kosova nuk ka Ministri të Energjisë, që nënkupton se racionalizimi i Agjencisë për Efikasitet duhet të shtyhet.

Bardhyl Dobra, duke u përgjigjur, tha se ekzistimi i Agjencisë për Efikasitet nuk garanton sukses, sepse është konsideruar dublifikim, andaj është paraparë racionalizimi i saj.

Valon Ramadani, konstatimet se numri i madh i agjencive në Kosovë është i panevojshëm kanë sjellë procesin e racionalizimit si të domosdoshëm duke përfshirë edhe faktet se edhe në vendet e BE-së agjencitë janë fuzionuar në ministri gjegjëse.

Mergim Lushtaku, theksoi se në parim procesi i racionalizimit është për tu vlerësuar, përveç kundërshtimeve që janë dhënë se si ka ardhur deri te termi OMNIBUS, ndërsa që është i domosdoshëm një diskutim më i gjerë për disa agjenci, si p.sh. Agjencia për Efikasitet, sa i përket pozitave të stafit të agjencisë ato duhet të zëvendësohen me pozita ekuivalente.

Ai pyeti se a ka ndonjë shembull se si funksionojnë agjencitë në vendet e tjera dhe nëse po, nga cilat vende kanë marrë shembull.

Bardhyl Dobra, tha se, eficiency mбетet, pёrkundrazi po konsolidohen mjetet pёr racionalizim, ndёrsa pёr termin OMNIBUS jemi tё njoftuar se ёshtё nё proces p/ligji pёr aktet juridike.

Sa i pёrket pyetjes lidhur me funksionimin e tyre nё vendet tjera, ato funksionojnё nё kuadёr tё ministrisё pёrkatёse, si rasti nё Austri dhe Hungari.

Konstatim: Pas diskutimeve, komisioni votoi, me shumicё votash, pёr miratimin e p/ligjit dhe vendosi qё Kuvendit t'ia paraqet kёtё:

R e k o m a n d i m

1. Tё miratohet nё parim Projektligji nr. 08/L-123 pёr ndryshimin dhe plotёsimin e ligjeve qё kanё tё bёjnё me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhёnёse tё Agjencive Ekzekutive.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputetja, Doarsa Kica - Xhelili, kryetare e Komisionit.

Arsyetim

Nё bazё tё nenit 56 paragrafi 2 tё Rregullores sё Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin nё parim, para leximit tё parё nё mbledhje plenare dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime pёr miratim nё parim.

Komisioni, pas shqyrtimit nё parim tё Projektligjit nr. 08/L-123 pёr ndryshimin dhe plotёsimin e ligjeve qё kanё tё bёjnё me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhёnёse tё Agjencive Ekzekutive, vlerёsoi se projektligji i plotёson kushtet e parapara sipas nenit 54 tё Rregullores sё Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e tij nё parim.

4. Tё ndryshme

Doarsa Kica - Xhelili, njoftoi komisionin se lidhur me email-in e pranuar nga njё sinjalizues lidhur me konfliktin e interesit nё ushtrimin e funksionit pёr kryetarin e KPM-sё, komisioni do tё drejtohet me kёrkesё pёr pёrgjigje nё AKK pёr rastin nё fjalё.

Mbledhja pёrfundoi nё orёn 12:00.

E pёrgatiti:

Stafi mbёshtetёs i Komisionit

**Doarsa Kica -Xhelili,
Kryetare e Komisionit**
